

## **Politika Mjedisore**

Autoriteti Portual Durres angazhohet për arritjen e standarteve më të larta të performancës mjedisore, duke parandaluar ndotjet dhe minimizuar impaktet e gjeneruara gjatë zhvillimit të aktiviteteve ngarkim/shkarkim/depozitim mallrash si dhe projekteve të implementuara për zhvillimin e Portit.

Autoriteti Portual Durres dhe punonjësit e saj do të veprojnë në përputhje me ligjet dhe rregullat për parandalimin e ndotjes dhe/ose dëmtimeve mjedisore ndaj tokës, ujit, biodiversitetit detar dhe atmosferës gjatë aktivitetit operacional, duke siguruar menaxhimin mjedisor të aktivitetit, si dhe do të implementojë programe dhe procedura për të siguruar përputhshmërinë me standartet mjedisore të aplikueshme.

Me besimin se cilësia, shërbimi për klientët dhe teknologjia e avancuar do të cojnë në përmirësim të vazhdueshëm në të gjitha zonat operationale të portit, synojme certifikimin me ISO 9001 dhe ISO 14001, duke ndërmarrë programe të menaxhimit të cilësisë dhe mjedisit që inkurajojnë bashkëpunim dhe komunikim, vendimarrje racionale, përmirësojnë eficientë operationale, identifikojnë dhe menaxhojnë riskun.

Gjatë zhvillimit të veprimtarisë do të:

- Integrojmë konsideratat e cështjeve dhe impakteve mjedisore në vendimarrjet e shoqërisë;
- Ndërgjegjësojmë në mënyrë të vazhdueshme punonjësit e Shoqërisë dhe kontraktorëve tanë dhe do t'i inkurajojmë për të punuar në mënyrë miqësore me mjedisin;
- Trajnojmë, edukojmë dhe informojmë punonjësit tanë rreth cështjeve mjedisore që do të ndikojnë punën e tyre;
- Gjatë zhvillimit të projekteve në port, do të kërkojmë nga kontraktorët reduktimin e mbetjeve përmes ri-përdorimit dhe riciklimit si dhe duke përdorur materiale të riciklueshme në projekt;
- Do të shmangim përdorimin e panevojshëm të materialeve dhe produkteve të rrezikshme si dhe do të ndërmarrim të gjithë hapat e nevojshëm për të mbrojtur shëndetin dhe mjedisin në rast se materiale të tilla do të përdoren ose depozitohen në zonën portuale;
- Kur kërkohet nga legjislacioni, ose kur egzistojnë rreziqe që kërcënojnë shëndetin dhe mjedisin, do të hartojmë dhe rifreskojmë Planin e kundërveprimit ndaj ndotjeve me hridrokarbure në det;

- Komunikojmë tek klientët dhe publiku angazhimin mjedisor, duke i inkurajuar ata që ta mbështesin atë;
- Do të fokusohemi për përmirësim të vazhdueshëm të performancës mjedisore dhe do të minimizojmë impaktet dhe dëmtimet sociale të aktiviteteve duke rishikuar politikat mjedisore në lidhje me aktivitetet e së ardhmes.

Gazmend SHALSI

Data: 11.03.2016

---

Drejtore i Përgjithshëm Ekzekutiv

